

VENDIM
Nr. 73, datë 22.8.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SA’GA-MAT” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GERMAN 1”, “GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE “GERMAN 4”.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 4.98 MW,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me fuqi totale 4.98 MW nga HEC-et “German 1”(me fuqi 1.2 MW), “German 2”(me fuqi 1.680 MW), “German 3”(me fuqi 1.29 MW) dhe “German 4”(me fuqi 0.81 MW).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti